



NJOFTIM NË LIDHJE ME REZULTATIN FINAL TË KONKURSIT PËR DREJTOR TË BORDIT NË NP “TERMOKOS” SH.A, PRISHTINË

Drejtorë Bordi në NP “Termokos” sh.a, Prishtinë, zgjedhen:

1. Visar Vokri
2. Vesa Kelmendi
3. Shukrije Morina
4. Mentor Maliqi

Në konkursin e datës 11.11.2022 për Drejtorë Bordi në NP “Termokos” sh.a, Prishtinë, kanë aplikuar gjithsejtë 42 kandidatë. Nga ky numër 23 i kanë plotësuar kushtet themelore dhe janë ftuar për intervistim, e nga të cilët 20 kanë prezentuar.

Komisioni Komunal i aksionarëve ka intervistuar kandidatët në intervalin 20 – 27 janar 2023, proces ky i realizuar në bashkëpunim dhe me pjesëmarrjen e projektit të Ambasadës Britanike në Kosovë, *Kosovo Senior Recruitment Process*, dhe përfaqësuesit nga shoqëria civile (GLPS).

Në analizim të performancës së treguar në intervistë, respektivisht poentimit nga të dya ekipet, rekomandimit të Projektit, hulumtimit në agjensionet përkatëse, në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike¹ me plotësim ndryshimin përkatës² dhe Ligjit për Barazi Gjinore³, Komisioni bëri zgjedhjen finale si më sipër.

Konform legjislacionit në fuqi dhe praktikave më të mira, Komisioni ka zhvilluar një procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese, me qëllim që përzgjedhja finale të bëhet ekskluzivisht në bazë të meritës.

KËSHILLË JURIDIKE: Kandidatët e pakënaqur me këtë vendim, mund të paraqesin ankesë pranë NP “Termokos” sh.a, Prishtinë, në afat 8 ditor nga publikimi i këtij vendimi.

¹Ligji për Ndërmarrjet Publike, nr. 03/L-087 (GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 31 / 15 QERSHOR 2008) neni, 17 par. 17.4.

²Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 03/L-087, (GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 10 / 07 maj 2015, PRISHTINË), neni 6.

³Ligji për barazigjinore, (GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 16 / 26 qershor 2015, PRISHTINË) neni 6 par. 8.